



NDIKIMI SOCIO EKONOMIK I PIVARA SHKUP NË MAQEDONI 2016



Coca-Cola HBC

Coca-Cola



HEINEKEN

PËRMBAJTJA

- Përmbledhje e studimit
- Pivara Shkup në ekonominë e Maqedonisë
 - Sektori për ushqim dhe pije në Maqedoni
 - Operacionet e Biznesit të Pivara Shkup
 - Numrat kryesor
- Përshkrimi i hulumtimit
 - Metodologjia e hulumtimit
 - Qëllimet e studimit
 - Modeli i matjes së ndikimit Socio-Ekonomik
 - Përmasat dhe të dhënat hyrëse
- Efektet e ndikimit të Pivara Shkup
 - Konkluzionet kryesore nga hulumtimi
 - Sektori i ushqimit dhe pijeve në MK
 - Sektorët kryesorë në të cilët ndikon Pivara Shkup
 - Konkluzione të hollësishme
 - Ndikimi në vlerën e shtuar
 - Ndikimi në punësim
 - Gjithsej në të ardhurat personale
 - Analiza e skenarëve
 - Kontributi tatimor për shtetin
- Përgjegjësi dhe Qëndrueshmëri Korporative
- Konkluzione

PËRMBLEDHJE E STUDIMIT

Qëllimi i studimit "Ndikimi socio-ekonomik i Pivara Shkup" është që duke e përdorur modelin ekonomik ta paraqesë nivelin e ndikimit të Pivara Shkup në ekonominë e Maqedonisë, duke përfshirë bruto vlerën e shtuar të gjeneruar, punësimin dhe të ardhurat personale. Raporti është përgatitur në bashkëpunim me *Deloitte Sustainability Consulting Central Europe* në periudhën ndërmjet muajve shkurt dhe mars të vitit 2017*.

Si

PRODHUES **NUMËR NJË** I PIJEVE

93 VJET

prezent në treg, qëllimi i Pivara Shkup është të demonstrojë përpjekjet e saj të vazhdueshme për të siguruar transparencë dhe të forcojë ndikimin në komunitetet lokale.

Kjo analizë e tregon ndikimin e Pivara Shkup në krijimin e vendeve të punës dhe mirëqenies, që dalin nga aktivitetet e saj nëpër tërë zinxhirin e vlerave. Qëllimi i raportit është biznes modeli i Pivara Shkup të jetë

**MË I LEHTË
PËR T'U KUPTUAR**

dhe për këtë arsye

**TË ANGAZHOHET
INTERESI PUBLIK**

në ndikimin më të gjerë ekonomik që Pivara Shkup e ka në ekonominë lokale nëpërmjet veprimeve dhe pranisë së saj.

Pivara Shkup siguron 377 vende pune të drejtpërdrejta* dhe hap rreth 1.370 punë shtesë në ekonominë maqedonase. Rreth

5.980 NJERËZ

janë pjesërisht ose tërësisht të varur nga të ardhurat personale e krijuara nga Pivara Shkup.

Të ardhurat personale totale që vijnë përmes zinxhirit të zgjeruar të vlerave të Pivara Shkup është i barabartë me bruto pagat mesatare mujore të

25.000
personave**

Furnizimet e Pivara Shkup prej

33,6 MIL. €

do të mundësonin financimin e një investimi në rreth

66 sala sportive

Rreth

21,1 MIL. €

janë paguar në tatime përmes prodhimit dhe shitjes së produkteve nga Pivara Shkup. Kjo është e barabartë me 12% nga tatimet totale të të ardhurave të korporatave të mbledhura nga qeveria në vitin 2016.

1.000

furnizues vendor në zinxhirin e vlerës së saj

The background features a stylized illustration of a multi-story building with arched windows and a grid-like facade, positioned diagonally. In the bottom left corner, there is a stylized sun or fan-like graphic with several curved lines radiating from a central point. The entire image has a warm orange-to-red gradient.

PIVARA SHKUP NË EKONOMINË E MAQEDONISË

SEKTORI PËR **USHQIM** **DHE PIJE** NË MAQEDONI

Që nga rënia ekonomike në vitin 2012, Maqedonia gradualisht po kthehet në rrugën e rritjes dhe zgjerimit.

Sektori i ushqimit dhe i pijeve, i cili është thelbësor për zhvillimin, prosperitetin dhe mirëqenien e ekonomisë së vendit, e ruajti rolin e saj si dalja më e rëndësishme për sektorin bujqësor, duke hapur vende pune për mbi 24.700 njerëz në të gjitha 1.677 bizneset.

Një nga industritë kyçe të sektorit – industria e pijeve – po fillon gjithashtu të stabilizohet që nga ngadalësimi nga viti 2012 deri në vitin 2014 vëllimi i prodhimit të birrës u rrit për 1,1% dhe vëllimi i prodhimit të pijeve joalkoolike u rrit për 5,2%. Industria e pijeve në tremujorin e katërt të 2015 siguroi mbi 3.400 vende pune, 20% më shumë se në tremujorin e katërt të vitit 2012 – nëse numri i vendeve të punës që industria mund t'i ofrojë do të rritet edhe për 20% deri në vitin 2019, atëherë do të krijohen edhe 687 vende pune shtesë.

Paga mesatare mujore në industrinë e pijeve gjithashtu është rritur për 7,9% që nga viti 2012, që është për 5 përqind më shumë se norma e inflacionit gjatë këtyre viteve. Industria e pijeve dhe i gjithë sektori i ushqimit dhe pijeve me siguri do të vazhdojë të luajë një rol jetësor në nxitjen e progresit socio-ekonomik të vendit, nëpërmjet krijimit të bruto vlerës së shtuar, vendeve të punës, eksporteve dhe promovimit të produkteve vendore.

OPERACIONET E BIZNESIT TË PIVARA SHKUP


Pivara Shkup ShA është një investim i e përbashkët midis Coca-Cola HBC AG dhe HEINEKEN N.V.

Historia e suksesit të saj filloi në vitin 1922 si ndërmarrja e parë aksionare me kapital dominant të huaj dhe birraria e parë në vend. Suksesi i gjerë është rezultat i investimeve të vazhdueshme të bëra me qëllim të njohjes së klientëve dhe konsumatorëve të saj me pijet joalkoolike dhe birrën me cilësi më të mirë.

Pivara Shkup është një prodhues i njohur ndërkombëtarisht i pijeve të markës Coca-Cola & HEINEKEN të prodhuar në vend në Maqedoni, duke përdorur në masë të madhe materiale dhe shërbime vendore. Rezultatet e aktiviteteve të Pivara Shkup, duke filluar nga prodhimi deri te shitja e produkteve të saj, tejkalojnë shumë rezultatet të cilat janë më të dukshme për konsumatorët dhe investitorët.

Përveç krijimit të vendeve të punës dhe të ardhurave personale në fabrikat e saj, ajo mbështet punësimin, të hyrat dhe të ardhurat nga tatimet në Maqedoni duke blerë mallra dhe shërbime nga furnizues të ndryshëm dhe duke i shitur përmes një rrjeti të gjerë distributiv të ardhurat e të cilëve varen nga konsumi i produkteve të Pivara Shkup.

ZINXHIRI I VLERAVE TË PIVARA SHKUP



NUMRAT KRYESOR

Mbi
40 MIL.€

investime kapitale
vetëm në 10
vitet e fundit

93
vjet në treg

Duke filluar nga
35.000 hektolitra birrë,
720 ton malt birre dhe 1.500
ton akull në 1924 deri në
985.000 hektolitra të pijeve
prodhuar sot në vit

7 marka themelore të pijeve
jo-alkoolike, me më shumë
se 60 paketime

4 marka themelore
të birrës, me më shumë
se 70 paketime

13,000 klientë, bashkëpunëtorë
të Pivara Shkup

11 qendra distributive
nëpër Maqedoni

2 fabrika prodhimi me
kapacitet prodhimi prej
2 milion hektolitra pije
joalkoolike dhe 1.1 milion
hektolitra birrë

Me krenari besojmë se çdo qytetar në Maqedoni ka
konsumuar të paktën një nga produktet tona.



PËRSHKRIMI I **HULUMTIMIT**

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Çdo ekonomi - qoftë e analizuar nëpërmjet një prizme kombëtare ose globale - përmban sektorë dhe industri që janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Brenda këtyre sektorëve dhe industrive ka kompani, operacionet e të cilave varen nga dhe ndikojnë në kompani të tjera dhe agentë ekonomik. Për të analizuar ndikimin socio-ekonomik të një kompanie ose të një industrie të përzgjedhur, duhet të përdorim një metodologji e cila i konsideron këto flukse dhe demonstroi se si rezultatet e industrive të ndryshme shërbejnë si input për industritë e tjera dhe si rrjedhim gjenerojnë vlera të shtuara, punësime dhe të ardhura personale në ekonomi.

QËLLIMET E STUDIMIT

KY STUDIM SYNON TË ARRIJË OBJEKTIVAT E MËPOSHTME:

1

Krijimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës të ndikimit të përgjithshëm të aktiviteteve të biznesit të Pivara Shkup duke përfshirë ndikimet e drejtpërdrejta, ndikimet indirekte të krijuara nga furnizuesit e saj dhe efektet e nxitura të krijuara përmes kompensimit të punonjësve në Pivara Shkup dhe kompensimit të punëtorëve të furnizuesve të Pivara Shkup dhe punëtorëve të furnizuesve së furnizuesve.

2

Vlerësim i tërësishëm i ndikimeve të ndryshme të Pivara Shkup brenda 21 sektorëve të ekonomisë së Maqedonisë.

MODELI I MATJES SË NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK

Marëdhëniet e Pivara Shkup me furnizuesit nga sektorë të ndryshëm ekonomik mundësojnë krijimin shtesë të bruto vlerës së shtuar, punësimit, të ardhurave dhe tatimeve në të gjithë ekonominë kombëtare. Në mënyrë që të identifikohen dhe të maten këto ndikime, u përdor një model i avancuar ekonomik që mundëson kuantifikimin e efekteve të operacioneve të Pivara Shkup në kushte direkte, indirekte dhe të detyruara.

Duke përdorur një model të bazuar në tabelën të hyrjes-daljes për ekonominë e Maqedonisë * dhe të dhënat nga kompania, janë llogaritur këto lloje të ndikimeve të Pivara Shkup:

NDIKIMET DIREKTE të cilat janë efektet e aktiviteteve të Pivara Shkup.

NDIKIMET INDIKRETE të cilat lidhen me transaksionet e biznesit të Pivara Shkup me furnizuesit e saj. Blerja e mallrave dhe shërbimeve nga furnizues vendor të Pivara hapin biznese për këta furnizues, duke u mundësuar atyre të ruajnë vendet e punës, të gjenerojnë vlera të shtuara dhe të ardhura personale. Por efektet nuk mbarojnë aty – furnizuesit e drejtpërdrejtë të Pivarës (niveli 1) kanë furnizuesit e tyre (niveli i 2), prodhimi i të cilave për shkak të impulsit fillestar nga Pivara Shkup, gjithashtu rritet, duke krijuar një efekt të valëzuar në ekonomi. Këto efekte, duke përfshirë të gjitha raundet e transaksioneve, në mënyrë efektive merren parasysh në modelin e përdorur.

NDIKIMET E DETYRUARA të cilat janë pasojë e një impulsi shtesë të krijuar në ekonominë përmes shpenzimit të punëtorëve të Pivara Shkup dhe shpenzimit të punëtorëve të furnizuesve të nivelit të parë dhe të dytë. Ky impuls, që manifestohet përmes kërkesës efektive, më pas pasqyrohet në një rritje të prodhimit në ekonomi, dhe përkthehet në punë shtesë, vlerë të shtuar dhe gjenerim të të ardhurave personale.

Shkalla e ndikimeve direkte, indirekte dhe të detyruara është paraqitur në lidhje me 3 treguesit kryesor:

01 BRUTO VLERA E SHTUAR (BVSh)

Vlera e prodhimit e zvogëluar për vlerën mesatare të konsumit (vlera e produkteve dhe shërbimeve në treg, të cilat prodhuesi i përdor si të dhëna në procesin e prodhimit). Bruto vlera e shtuar (BVSh) në çmimet bazë është e barabartë me bruto produktin vendor (BPV) të çmimeve të tregut minus tatimet plus subvencionet për produktet.

02 PUNËSIMI

Matur në aspektin e numrit të punëtorëve dhe duke përfshirë të gjitha vendet e punës të fuqisë punëtore, gjegjësisht të punësuar dhe të vetëpunësuar.

03 TË ARDHURAT PERSONALE

Matur përmes të ardhurave personale të punëtorëve, që përfshin pagat dhe mëditjet, kompenzimet e shtuara në paga, kontributet sociale dhe tatimet mbi pagat.

Përveç kësaj, ndikimet fiskale direkte dhe indirekte të tatimeve të paguara nga Pivara Shkup janë të kuantifikuara dhe janë vënë në kontekst në pjesën e ardhshme të raportit.

NDIKIMI I DETYRUAR



NDIKIMI INDIREKT NIVELI 2



NDIKIMI INDIREKT NIVELI 1



NDIKIMI DIREKT



PIVARA SHKUP



PUNËSIMI



SHTETI

PËRMASAT DHE TË DHËNAT HYRËSE

Studimi fokusohet në përcaktimin e sasisë së ndikimeve të Pivara Shkup në ekonominë lokale të Maqedonisë. Prandaj, blerja e mallrave dhe shërbimeve nga shitësit e huaj ishin përjashtuar nga llogaritjet e ndikimeve indirekte dhe të detyruara, pasi ato nuk kanë ndikim në punësimin vendor, bruto vlerën e shtuar ose të ardhurat.

Analiza u krijua duke përdorur të dhënat financiare të mbledhura nga Pivara Shkup për vitin 2016, duke përfshirë:

- bilancet vjetore për fitimet dhe humbjet,
- Regjistrimet e pagesave tatimore,
- të dhënat e punësimit mesatar në vitin 2016 (duke përfshirë punëtorët e punësuar direkt dhe përmes palëve të treta),
- Të dhënat lidhur me blerjet e ndara në shpenzimet vendore dhe të huaja,
- informacion mbi pagat e punëtorëve dhe tatimet mbi të ardhurat personale të mbledhura në emër të tyre nga Pivara Shkup
- informacion për shpenzimet e marketingut të Pivara Shkup

Përveç kësaj, **kompania Coca-Cola** investoi **1,4 MIL. €** në vitin 2016 në aktivitetet e marketingut ATL.

Statistikat dhe të dhënat për kompensimin e të punësuarve dhe punësimit (duke përfshirë të vetëpunësuarit) të siguruara nga Enti Shtetëror i Statistikës janë marrë për të njëjtin vit si tabela simetrike të hyrjes-daljes viti 2010, për të mbajtur raporte të qëndrueshme për produktivitetin dhe fitimet.



EFËKTET E NDIKIMIT TË PIVARA SHKUP

KONKLUZIONET KRYESORE NGA HULUMTIMIT



BRUTO VLERA E SHITUAR

44,6 MIL. €

PUNËSIMI

**1.747 VENDE
PUNË**

TË ARDHURAT PERSONALE

13,7 MIL. €

Ndikimi direkt
24,5 MIL. €

Ndikimi indirekt
12,4 MIL. €

Ndikimi i detyruar
7,7 MIL. €

Ndikimi direkt
377 vende pune

Ndikimi indirekt
875 vende pune

Ndikimi i detyruar
495 vende pune


Ndikimi direkt
6,4 MIL. €

Ndikimi indirekt
4,5 MIL. €

Ndikimi i detyruar
2,8 MIL. €

SEKTORËT KRYESORË NË TË CILËT NDIKON PIVARA SHKUP

Janë identifikuar tre sektorë kryesorë të ekonomisë në të cilët Pivara Shkup ka ndikim më të madh.



Shërbime për marketing, IT, inovacion dhe teknologji, shërbime biznesi dhe shërbime ligjore

Shërbimet e nevojshme për të ruajtur shërbimet e prodhimit dhe shërbimet e biznesit duke përfshirë montimin dhe riparimin e makinerive, mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës dhe blerjen e materialeve të zyrës, si dhe përmes shitjeve të produkteve të Pivara Shkup.

Burime lokale të lëndëve të para të tilla si sheqer dhe oriz i thyer.

NDIKIMET LIDHEN ME:

Sektorët kryesorë të prekur
nga Pivara Shkup në milion €



BRUTO VLERA
E SHTUAR



PUNËSIMI



TË ARDHURAT
PERSONALE



4,7 MIL. €



252 VENDE
PUNE



1,7 MIL. €

Shërbime profesionale



2,5 MIL. €



184 VENDE
PUNE



1,0 MIL. €

Me pakicë



4,6 MIL. €



418 VENDE
PUNE



1,2 MIL. €


Bujqësi

Burimi: Përllogaritjet e Deloitte bazuar në të dhënat e ofruara nga Pivara Shkup dhe Modeli i hyrjes – daljes të ekonomisë së Maqedonisë

KONKLUZIONET E HOLLËSISHME

NDIKIMI NË VLERËN E SHTUAR: 44,6 MIL. €


Bruto vlera totale e shtuar e krijuar në Maqedoni përmes aktivitetit të Pivara Shkup në vitin 2016, të ndara sipas sektorëve dhe llojit të ndikimit (në € milion)



Burimi: Përllogaritjet e Deloitte bazuar në të dhënat e ofruara nga Pivara Shkup dhe Modeli i hyrjes – daljes të ekonomisë së Maqedonisë

NDIKIMI NË PUNËSIM: 1.747 VENDE PUNE

Gjithsej punësimi i mbështetur në Maqedoni nëpërmjet aktivitetit të Pivara Shkup në vitin 2016, të ndara sipas sektorit dhe llojit të efektit (në persona).




Burimi: Përllogaritjet e Deloitte bazuar në të dhënat e ofruara nga Pivara Shkup dhe Modeli i hyrjes – daljes të ekonomisë së Maqedonisë

*Sektorë të tjerë përfshijnë: germim dhe nxjerrje të gurit, produkte tekstili, druri dhe letre, shërbime shtypi dhe inçizimi, produkte kimike, gome dhe plastike, produkte tjera, shërbime ndërtimi, akomodimi dhe shërbime ushqimore, shërbime administrative dhe për përkatje, dhe sektorë të tjerë.

KONKLUZIONET E HOLLËSISHME

GJITHSEJ NË TË ARDHURAT PERSONALE: 13,7 MIL. €

Gjithsej të ardhurat personale të realizuara në Maqedoni nëpërmjet aktivitetit të Pivara Shkup në vitin 2016, të ndara sipas sektorit dhe llojit të efektit (në milion €).



Burimi: Përlllogaritjet e Deloitte bazuar në të dhënat e ofruara nga Pivara Shkup dhe Modeli i hyrjes – daljes të ekonomisë së Maqedonisë

ANALIZA E SKENARËVE

Një skenar në të cilin një prodhues nuk bën përpjekje për të blerë materiale dhe shërbime nga furnizuesit vendor do të thotë një rezultat ekonomik që ul ndjeshëm vlerën e shtuar në tregun e brendshëm. Një pjesë e materialeve të prodhimit të Pivara Shkup duhet të importohen, por si do të duket ndikimi nëse një prodhues me profil të Pivara Shkup përdor vetëm materiale dhe shërbime të importuara?

Në një rast të tillë, humbjet ndaj bruto vlerës së shtuar për ekonominë do të ishin **15,5 MIL. €** dhe tregu i punës do të pësonte një humbje prej **1078 vende** të punës.

Sektorë më të prekur:

SHËRBIET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE

humbja BVSh: 4,4 MIL. €
humbja e vendeve të punës: 234 vende pune
humbje e të ardhurave personale: 1,6 MIL. €

PRODUKTE BUJQËSORE

humbja BVSh: 4,1 MIL. €
humbja e vendeve të punës: 368 vende pune
humbja e të ardhurave personale: 1,1 MIL. €

SHËRBIET NË TREGTI ME SHUMICË DHE PAKICË DHE RIPARIME


humbja BVSh: 1,5 MIL. €
humbja e vendeve të punës: 108 vende pune
humbja e të ardhurave personale: 0,6 MIL. €

*Në supozim se 100% e lëndëve të para janë të importuara.

KONTRIBUTI TATIMOR PËR SHTETIN

Pivara Shkup ka një volum të lartë të prodhimit dhe një pjesë të madhe të tregut të konsumatorëve që prodhon shumë të ardhura si për Pivara Shkup gjithashtu dhe për shtetin e Maqedonisë.

Kontributi i përgjithshëm tatimor i Pivara Shkup në vitin 2016 përbëhet nga akciza, TVSH, tatimet e punonjësve, tatimi i fitimit si dhe tatimet e tjera të prodhimit është **21,1 MIL. €**. Tatimet e akcizës dhe TVSH-së janë tatimet indirekte të cilat llogariten mbi **17,1 MIL. €** ndërsa tatimet e drejtpërdrejta të paguara nga Pivara dhe punëtorët e Pivara Shkup arrijnë në **4 MIL. €**.



Burimi: Përllogaritjet e Deloitte bazuar në të dhënat e ofruara nga Pivara Shkup



PËRGJEGJËSI DHE QËNDRUESHMËRI KORPORATIVE

VENDOSJA E CAQEVE TË LARTA

Pivara Shkup është e angazhuar për të kontribuar në një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme. Qëndrueshmëria ka qenë themelore për Pivara Shkup që nga viti 1922 dhe qëndron në zemër të gjithçkaje që bëjnë. Ndërtimi i besimit të komunitetit përmes menaxhimit të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të biznesit është një pjesë thelbësore e kulturës sonë.

Pivara Shkup do të vazhdojë të investojë në mënyrë të konsiderueshme në mënyrë që të krijojë vlerë të përbashkët me punëtorët, komunitetin, konsumatorët, konsumatorët dhe aksionarët, duke përcaktuar objektiva ambicioze afatgjatë të qëndrueshmërisë dhe duke raportuar për progresin. Ndikimi i Pivara Shkup në komunitet është i vendosur për të mbështetur dhe përmirësuar cilësinë e jetës së të gjithë anëtarëve.

SHËNDETI DHE SIGURIA


Pivara Shkup është pioniere në vend në fushën e Shëndetit dhe Sigurisë dhe një shembull i praktikave të shkëlqyera në industrinë vendase të pijeve. Kompania është ndër të parat në vitin 2007 që u njoh dhe certifikua nga standardi kryesor ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë - OHSAS 18001. Për të ruajtur një mjedis pune të shëndetshëm dhe të sigurt, Pivara Shkup organizon aktivitete, trajnime, prezantime dhe stërvitje të ndryshme gjatë tërë vitit përmes të cilave të gjithë punëtorët marrin dhe përditësojnë njohuritë e tyre në këtë segment të rëndësishëm.

VULLNETARËT E PIVARA SHKUP EDUKUAN POTHUAJSE ÇDO NXËNËS TË KLASËS SË KATËRT PËR SHËNDETIM DHE SIGURINË NËPËR SHKOLLA

Për katër vite të njëpasnjëshme, Pivara Shkup, në bashkëpunim me komunat dhe shkollat fillore, realizon një projekt edukativ mbi temat që lidhen me shëndetin dhe sigurinë, të destinuara për nxënësit e klasës së katërt. Projekti zbatohet përmes prezantimeve interaktive dhe grafike të përshtatura për moshën e nxënësve përmes të cilave ata, në prani të mësuesve të tyre, marrin këshilla se si ta mbajnë trupin drejtë kur rrinë ulur në bankat e shkollës dhe kur punojnë në kompjuter, si t'i mbajnë siç duhet çantat e shkollës, si të parandalojnë dëmtimet e shkaktuara nga rrëshqitja, goditja dhe rënia, dhe si të veprojnë në rast zjarri në shkollë.

18,500	Nxënës / 4 vjet
16	Komuna
114	Shkolla
63	Vullnetarë nga Pivara Shkup
167	Orët e vullnetarëve

Numri i nxënësve gjatë gjithë viteve



*Ekzekutuar gjatë përpilimit të broshurës
100% të nxënësve të klasës së katërt në vend



ÇMIMI KOMBËTAR PËR PRAKTIKËN MË TË MIRË NË FUSHËN E SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË

Shoqata maqedonase për mbrojtje në punë
dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës

STIMULIMI I RINISË

19 VJET TRADITË NË ARSIMIMIN E STUDENTËVE DHE 1 VIT PROGRAM PËR TRAJNIM FALAS

Qendra Edukative e Pivara Shkup ekziston tashmë 19 vjet. Ajo fillimisht u themelua për edukimin e punëtorëve, ndërsa më vonë u bë një nga Qendrat më të respektuara të Edukimit për të rinjtë në vend.

Me qëllim të mbështetjes së masave dhe përpjekjeve të institucioneve shtetërore kompetente dhe Qeverisë për të reduktuar më tej papunësinë, veçanërisht në mesin e të rinjve, në 2016 Pivara Shkup filloi programin **"Shkathtësitë për sukses"** duke u dhënë përparësi të rinjve që vijnë nga kategoritë e rrezikuara sociale. Pivara Shkup mbulon kostot e përgjithshme të trajnimit të pjesëmarrësve duke e bërë trajnimin tërësisht pa pagesë për të gjithë pjesëmarrësit. Përveç drejtuesve të Pivara Shkup, përfaqësues të tjerë kryesorë të biznesit, ekspertë të universiteteve, institucioneve publike, si dhe organizata të respektuara ndërkombëtare janë përfshirë si ligjërues në trajnime. Që nga viti 1997, përmes qendrës edukative të Pivara Shkup janë trajnuar **4.300** studentë

NDIKIMI

Promovimi i barazisë gjinore dhe grave sipërmarrëse

Inkurajimi i një fryme sipërmarrëse

Reduktimi i shkallës së papunësisë të të rinjve

Qëndrimi pozitiv për programin

Gjithsej pjesëmarrës deri më sot

STATISTIKAT

2/3 e pjesëmarrësve janë gra


4% e pjesëmarrësve kanë filluar biznesin e tyre

33% e pjesëmarrësve të papunë gjetën punë për 12 muaj

96%

4.300

GJITHSEJ PJESËMARRËSIT



*Të gjitha shpenzimet e mbuluara nga Pivara Shkup



ÇMIMI KOMBËTAR PËR INVESTIM NË KOMUNITET PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË RINJVE
Organi koordinues kombëtar për Përgjegjësi korporative shoqërore.
Programi i ndarjes së fondeve i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Ministria e Ekonomisë.

MIRËQENIA E KOMUNITETIT

Për 6 vjet Pivara Shkup frymëzon dhe angazhon njerëzit në një mënyrë jetese aktive, duke filluar nga kupa Coca-Cola deri në donacionin e Zonave aktive Coca-Cola në vend, të zbatuara për herë të parë në vitin 2016, në bashkëpunim me qeverinë lokale dhe OJQ-të ndërkombëtare "Shkollat argëtuese të hapura të futbollit".

Zonat aktive të Coca-Cola janë një projekt afatgjatë për sigurimin e zonave aktive rekreative dhe sportive të hapura, të pajisura me pajisjet më të sofistikuar të fitnesit, të disponueshme për të gjithë qytetarët 24/7 pa pagesë. Qëllimi i këtij projekti është që të inkurajojë njerëzit për ushtrimin e aktiviteteve fizike, sportive dhe rekreative, duke u argëtuar dhe shoqëruar. Deri tani, zonat aktive Coca-Cola janë dhuruar në 10 komuna në të gjithë vendin.

Projekti i fundit i Pivara Shkup, dhurimi i stacioneve të parkimit të biçikletave është kontributi në promovimin e biçiklizmit rekreativ dhe urban si një stil jetese dhe ngritja e vetëdijes për përdorimin e biçikletave si transport urban me efikasitet energjetik, i cili ka potencial të lartë në zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe në mbrojtjen e mjedisit

Coca-Cola kupa e futbollit

- mbi 6.000 djem dhe vajza 12-16 kanë "lëvizur" deri më tani
- mbi 200 lojra janë luajtur
- 18 komuna të përfshira
- mbi 150 shkolla të ndryshme të angazhuara



Stacione biçikletash

- 5 stacione biçikletash të hapura
- 55.000 njerëz kanë përfituruar në të gjithë vendin



Coca-Cola zonat aktive

- 10 zona aktive janë hapur
- 6.000 njerëz kanë përfituruar në të gjithë vendin



UJI DHE MJEDISI

Minimizimi i ndikimit në mjedis është një nga objektivat kryesore të Pivara Shkup. Vazhdimisht kërkohen mënyra të reja për të zvogëluar konsumin e ujit dhe energjisë dhe për të zvogëluar mbeturinat. Të gjitha përpjekjet kanë rezultuar në marrjen e lejes së integruar mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, e cila konfirmon se Pivara Shkup në të gjitha segmentet e veprimtarisë së saj zbaton standardet më të larta të mbrojtjes së mjedisit. Gjatë viteve janë bërë investime të gjera, arriti në mbi **3 milionë euro** për të përbushur të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Planin Operacional për marrjen e licencës.

Pivara Shkup është një nga iniciatorët dhe themeluesit e organizatës së parë për menaxhimin e mbeturinave të paketimit në vend "Pakomak". Së bashku me Pakomak, Pivara Shkup vazhdimisht kryejnë aksione ekologjike për ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e mjedisit, duke mbështetur kështu organizatën e saj në arritjen e objektivave kombëtare për mbeturinat e paketimit dhe kontribuimin drejt një ambienti të shëndetshëm dhe të pastër.

NËN MOTON "A RICIKLONI!?"

- Dy vjet me radhë, vullnetarisht, punëtorët dhe drejtuesit e Pivara Shkup, së bashku me Ambasadën e Holandës në Maqedoni, Ambasadën Britaneze dhe kompaninë Pakomak, organizojnë aksione për mbledhjen e mbeturinave të paketimit nga hapësira publike si bregu i lumit Vardar dhe Liqenin Matka. Brenda aksioneve, të gjithë mbeturinat e thata mbledhen, selektohen në mënyrë të duhur dhe dërgohen në riciklim.
- Së bashku me Ambasadën e Holandës në Maqedoni dhe kompanitë Pakomak dhe Zero Waste, Pivara Shkup po zhvillon një projekt për edukimin e fëmijëve nga mosha më e re në lidhje me metodat dhe përfitimet nga riciklimi dhe trajtimi i duhur i mbeturinave. Projekti realizohet përmes një shfaqje inovative dhe të këndshme teatri të titulluar "Planeti i gjelbër", e dedikuar për fëmijë nga klasa e parë deri në klasë të pestë. Deri tani, nëpërmjet **12 shfaqjeve teatrale**, të paraqitura në **8 qytete** anembanë vendit, **8.420 fëmijë** janë edukuar për rëndësinë e mbajtjes së mjedisit jetësor të shëndetshëm dhe të pastër.



SISTEM PËR TRAJTIM TË UJËRAVE TË ZEZA

Një nga investimet më të rëndësishme të Pivara Shkup është Sistemi i Trajtit të Ujërave të Zeza i cili është i vetmi i këtij lloji në vend. Sistemi pastron ujin nga procesi i prodhimit vetëm me mjete biologjike dhe paraqet një inovacion të teknologjisë së lartë e aplikuar për herë të parë nga industria në vend. Kjo teknologji e fundit lejon që trajtimi i ujit nga procesi i prodhimit të ri-përdoret më pas si ujë industrial, ndërsa shkarkimet e gazrave të lëshuara gjatë trajtimit të ujit përdoren për prodhimin e energjisë.



MIRËNJOHJE KOMBËTARE PËR MJEDISIN PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA

Organi koordinues kombëtar për Përgjegjësi korporative shoqërore. Programi i ndarjes së fondeve i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Ministria e Ekonomisë.

NDIHMË SOLIDARE

Një nga angazhimet kryesore strategjike të Pivara Shkup është të sigurojë ndihmë për ata që janë më në nevojë. Bazuar në bashkëpunimin afatgjatë që ka me Kryqin e Kuq të Maqedonisë, kjo është konfirmuar në shumë raste përmes ndihmës dhe logjistikës në shumë aktivitete humanitare, raste të fatkeqësive natyrore dhe aksidenteve.

Në gusht të vitit 2016, natyra përsëri ka lëshuar të gjithë fuqinë e saj duke bërë përmbytje shkatërruese me pasojë tragjike në Shkup. Duke dhuruar fonde monetare, ujë të pijshëm dhe ndihmë vullnetare, Pivara Shkup dhe Kompania Coca-Cola mbështetën Organizatën e Kryqit të Kuqit, Komunën e Gazi Babës dhe institucionet tjera relevante në lehtësimin e pasojave nga kjo fatkeqësi natyrore



70
punëtorë

Ndihmë në baza
vullnetare

210

Orët vullnetare

32 t.
ujë

janë dhuruar

100.000
euro

janë dhuruar

KONSUMI MESATAR I ALKOOLIT

Pivara Shkup beson se vetëm konsumimi i përgjegjshëm mund të sigurojë kënaqësi të vërtetë të birrës. Pirja e tepërt nuk do të thotë sukses për biznesin dhe nuk kontribuon në rritjen e qëndrueshme të shoqërisë. Pivara ka zhvilluar dhe përmirësuar fushatën për konsumin e përgjegjshëm të birrës për të rritur ndërgjegjësimin për konsumin e përgjegjshëm dhe për të reduktuar përdorimin e dëmshëm të alkoolit. Kompania beson se si prodhues më i madh i birrës në vend ka obligim afatgjatë të përhap kulturën e konsumit të përgjegjshëm dhe t'i ndërfus dhe jetojë vlerat e konsumit të përgjegjshëm si pjesë e jetës së përditshme në komunitetin ku i përket.

Në përhapjen e kulturës së konsumit të përgjegjshëm, Pivara Shkup, përveç të gjithë punëtorëve, bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të saj, ka përfshirë shumë figura të suksesshme publike që shërbejnë si shembull për qytetarët e tjerë, veçanërisht të rinjtë, me sjelljen e tyre dhe mesazhet personale. Ky grup i ambasadorëve për konsumim të përgjegjshëm i Pivara Shkup ndër të tjera gjithashtu përfshin një numër të madh të mbështetësve, siç janë pjesëtarët e ekipit kombëtar maqedonas të hendbollit, por edhe dashamirët e motoçikletave dhe kulturës së motoçikletave, përfshirë Presidentin e klubit motorik kombëtar, kampionin e garave ndërkombëtare të automjeteve dhe zhytësen speleologjike të famshme botërore, të cilët duke folur për përvojat e veta, rekomandojnë konsumim të përgjegjshëm. Pivara Shkup bashkëpunon në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme me të gjithë institucionet dhe OJQ-të relevante në realizimin e aktiviteteve pjesë e procesit të përhapjes së kulturës së konsumit mesatar të alkoolit.

PËRKRAHJA E GRAVE

Përkrahja e gruas është një nga përcaktimet strategjike të Pivara Shkup. Pivara Shkup beson fuqishëm që përkrahja e grave që tërësisht të marrin pjesë në ekonomi është thelbësore drejt prosperitetit, zhvillimit dhe qëndrueshmërisë dhe mund të përmirësojë cilësinë e ekonomisë, jetën dhe komunitetin në tërësi. Pivara Shkup ka qëllime dhe strategji të qarta për suksesin e tregut dhe angazhimin e përgjithshëm të komunitetit, duke u angazhuar thellësisht në zhvillimin e ndjenjës së diversitetit dhe drejtësisë së punëtorëve në të gjitha aspektet e punës të kompanisë, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë për mësim, zhvillim, promovim dhe kontribut në biznese dhe komunitet.



GOTA E PLOTË

Gota e plotë është platforma e parë dhe e vetme e korporatave botuese në vend. Ka filluar më 1 janar të vitit 2016 dhe menjëherë bëhet e njohur nga konsistenca e saj dhe përmbajtja e përzgjedhur me kujdes që integron intervistat dhe artikujt nga punëtorët, partnerët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Gota e plotë stimulon tregimet rreth konsumit të përgjegjshëm të alkoolit, përkrahjen e të rinjëve, përkrahjen e gruas, stilin e jetës aktive, shëndeti dhe siguria, mirëqenia e komunitetit dhe mbrojtja e ujit dhe mjedisit duke reflektuar kështu identitetin e korporatës të Pivara Shkup.



QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Falë iniciativave të fundit, Pivara Shkup kontribuon dukshëm në investimet e përgjithshme dhe arritjet e Coca-Cola HBC në zhvillimin e qëndrueshëm, ndër të cilat janë:

Reduktimi direkt dhe indirekt i emisioneve të dioksidit të karbonit për

7,8%

në vit

Investime prej

5,8

MIL. € në instalime që lejojnë kursime prej

1,1

milion metra kub ujë

4,3

MIL. € të investuara në projekte të efikasitetit energjetik.

PIVARA SHKUP ËSHTË SPONSOR AFATGJATË I:

35

VJET

FEDERATA E
HENDBOLLIT
MAQEDONAS



43

VJET

DASMA E
GALIÇNIKUT



27

VJET

FESTIVALI
VERA E OHRIT



NË SUAZA VJETORE PIVARA SHKUP MBËSHTET:

26

NGJARJE
EDUKATIVE

16

NGJARJE
SPORTIVE

15

NGJARJE
HUMANITARE

27

NGJARJE
KULTURORE

KONKLUZIONE



NDIKIMI I NË EKONOMI



BVSh 44,6 MIL. €

TË ARDHURAT PERSONALE 13,7 MIL. €

TATIMET 21,1 MIL. €



1.747 VENDE PUNE NË
ZINXHIRIN E VLERËS



1 VEND PUNE NË
SISTEMIN MBËSHTETËS



3,6 VENDE PUNE TË
TJERA NË MAQEDONI

KONKLUZIONE

Në ekonominë të sotshme botërore konkurruese po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme rritja e ndikimeve ekonomike lokale dhe mbështetja e vendeve të punës.

Pivara Shkup gjeneron.

44,6 MIL. €

bruto vlerë të
shtuar në Maqedoni.

Kjo vlerë krijon efekte valëzimi
në të gjithë ekonominë e cila mbështet

**1.747 VENDE
PUNE**

mbi katër herë më shumë nga
punësimi i drejtpërdrejtë
në kompani

Rreth

5.980 NJERËZ

Pjesërisht ose tërësisht të varur
nga të ardhurat personale e krijuara
nga Pivara Shkup.

Shumica e vendeve të punës të
mbështetura përmes operacioneve të Pivara
Shkup janë në sektorët jetësorë të ekonomisë siç janë
Shërbimet Bujqësore dhe Shitje me Pakicë, Tregti dhe
Riparime. Vendet e punës në këta sektorë dhe sektorë të tjerë
janë të rëndësishme, sepse shumë familje lokale mbështeten
në të ardhurat personale e fituara në vend – pothuajse

13,7 MIL. €

në të ardhura personale mund të jetë falë
pranisë së Pivara Shkup
në Maqedoni.

Rreth

21,1 MIL. €

paguhet në tatime nëpërmjet prodhimit
dhe shitjes së produkteve të Pivara Shkup.
Kjo është e barabartë me 12% të totalit të
taksave korporative mbi të ardhurat të
mbledhura nga qeveria në vitin 2016.

Ndikimi lokal i Pivara Shkup
mund të llogaritet dhe vlerësohet, por
ndikimi i komuniteteve lokale në Pivara
Shkup nuk mundet. Pa mbështetjen lokale të
komuniteteve Pivara Shkup nuk mund të
funksionojë, prandaj falënderojmë singërisht
secilin prej furnizuesve tanë dhe çdo
konsumator të fundit që kanë ndikim
në ndikimin tonë.

Studimi "Ndikimi socio-ekonomik i Pivara Shkup" është në dispozicion në internet:
www.polnacasa.mk



